



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
-REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
OPSTINE SUVA REKA  
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



# RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT JANAR – MARS 2024

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRJE DOREZIM PRILMJEJTO - RECEIVED			
Nësi e g. Org. Jeshile Org. Unit	Numri Braj Number	Shtesa Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	17900	2

BALI MUHARREMAJ

Email: [ bali.muharremaj@rks-gov.net]

Websit: [https://kk.rks-gov.net/suhareke/]

Raporti tre mujor i punës së kryetarit dhe drejtorive komunale Janar-Mars 2024.

Ky raport përfshin realizimin e shumë projekteve të cilat janë caktuar sipas Planit të Punës për këtë vit kalendarik, pra për vitin 2024, për periudhën 3 mujore Janar-Mars 2024.

Përmes prezantimit të mëposhtëm, të secilës drejtori dhe sektorëve të caktuara, ju qytetarë të nderuar dhe të interesuar, do të njoftoheni për të dhënat konkrete edhe përmes statistikave, në secilin dikaster dhe sektor në drejtorinë e Komunës së Suharekës.

Përmes njoftimeve publike, rrjeteve sociale, ueb faqes zyrtare, diskutimeve publike, me qytetarë, ne kemi njoftuar ecurinë e vazhdimin e projekteve dhe punëve të përditshme.

Komuna e Suharekës është e përkushtuar që secilit qytetarë ti shërbej me nder e gjithmonë duke respektuar ligjin.

Më poshtë për secilën drejtori gjeni raportet e përgaditura:

## Drejtoria për Shërbime Pronësore Juridike, Gjeodezi dhe Kadastër

Drejtoria për shërbime pronësore juridike, gjeodezi dhe kadastër, në përputhje me objektivat dhe kompetencat e saj, është përqendruar në përmbushjen e Planit të Punës për periudhën raportuese Janar – Mars 2024

Raporti pasqyron veprimet dhe rezultatet e arritura sipas fushave të planifikuara:

1. Zbatimi me përpikmëri i legjislacionit përkatës me kompetencat e secilit zyrtar shërbyes
2. Ofrimi i shërbimeve sa më të mira dhe në kohë sa më optimalë të mundshme
3. Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies sipas hierarkisë së Drejtorisë
4. Ngritja e performancës së punës
5. Ngritja e performancës së shërbimeve në sportel
6. Komunikimi profesional me palët e interesuara
7. Zbatimi i sugjerimeve nga hierarkia komunale
8. Zbatimi i rekomandimeve dhe sugjerimeve nga Agjencioni kadastral i Kosovë

### ***Përmbledhje ekzekutive***

Përgjatë periudhës Janar – Mars 2024 DSHPJGJK ka përmbushur një pjesë të rëndësishme të detyrave të planifikuara nga stafi i drejtorisë

DSHPJGJK ka realizuar aktivitetet konform përgjegjësisë dhe planifikimeve të bëra, duke përfshirë: realizimin në plotëni të planit të punës, kornizës së planit të punës për vitin 2024, për periudhën raportuese në këtë raport, ofrimin e shërbimeve për qytetarë, bashkëpunimin ndërkomunal dhe bashkëpunimin me Agjencionin kadastral të Kosovës si organ mbikëqyrës së punës të Departamentit të gjeodezisë dhe kadastrit,

Gjatë kësaj periudhe Janar – Mars 2024, janë pranuar dhe shqyrtuar kërkesat e qytetarëve, të cilët kanë parashtruar pranë drejtorisë sonë, të cilat janë shqyrtuar në kohë sa më optimalë të mundshme duke u ndalur këtu edhe tek një problem siq është mungesa e theksuar e stafit, si dhe rritja enorme e kërkesave të palëve, po ashtu vërehet dukshëm një rritje e madhe dhe një trend në rritje i kërkesave të qytetarëve që kërkojnë shërbimet tona si drejtori, megjithatë edhe pse me staf të reduktuar ne kemi punuar me kompetencë të lartë duke u munduar që ta trajtojmë me kujdes dhe koherencë çdo kërkesë të qytetarëve.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, ne kemi përgaditur dhe raportuar disa herë në baza javore dhe mujore lidhur me punën dhe aktivitetin tone.

Lëndët e procesura sipas llojit të saj.

Lloji i lëndes	Komuna	Total	Lendet e Aprovuar	Lendet e Refuzuara	Lendet e Procesuara
Bartja e posedimit - Ndarje fizike	SUHAREKË	7	7	0	7
Bartja e posedimit - Blerje	SUHAREKË	69	69	0	69
Bartja e posedimit - Dhurim	SUHAREKË	93	93	0	93
Bartja e posedimit - Këmbim	SUHAREKË	4	4	0	4
Bartja e posedimit - Në bazë të pranimit	SUHAREKË	162	161	1	162
Bartja e posedimit - Shpronësim	SUHAREKË	0	0	0	0
Bartja e posedimit - Trashëgimi	SUHAREKË	26	26	0	26
Bartja e posedimit - Vërtetim pronësie	SUHAREKË	29	29	0	29
Bartja e pronësisë - Trashëgimia	SUHAREKË	0	0	0	0
Bartja e pronësisë - Vërtetim pronësie	SUHAREKË	0	0	0	0
Bashkimi	SUHAREKË	30	30	0	30
Bashkimi i personave të njejtë me ID të ndryshme	SUHAREKË	48	48	0	48
Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit	SUHAREKË	9	9	0	9
Krijimi i kopjes zyrtare të planit	SUHAREKË	421	0	0	421
Modifikimi atributëve të parces	SUHAREKË	22	22	0	22
Modifikimi i hipotekës	SUHAREKË	1	0	1	1
Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale	SUHAREKË	13	13	0	13
Modifikimi i të drejtave	SUHAREKË	9	9	0	9
Ndarja	SUHAREKË	108	108	0	108
Regjistrimi i hapësirave të përbashkëta	SUHAREKË	0	0	0	0
Regjistrimi i hipotekës	SUHAREKË	10	10	0	10
Regjistrimi i ndërtesës	SUHAREKË	24	24	0	24
Regjistrimi i ngarkesës tatimore	SUHAREKË	1	1	0	1
Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës	SUHAREKË	35	35	0	35
Regjistrimi i qiramarrjes	SUHAREKË	0	0	0	0
Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit	SUHAREKË	0	0	0	0
Regjistrimi i vërejtjes me vendim të gjykatës	SUHAREKË	0	0	0	0
Shërbimi i të dhënave - nxjerrja e Certifikatës	SUHAREKË	1157	0	0	1157
Shërbimi i të dhënave Vërtetim që nuk posedon pronë	SUHAREKË	155	0	0	155

**Raport mbi poseduesit /pronarët sipas gjinisë për periudhën kohore Janar – Mars 2024**

- ✓ Pronarë meshkuj: 142
- ✓ Pronare femra: 21
- ✓ Gjithsej: 163

## Numri i Aplikantëve në periudhën kohore raportuese Janar – Mars 2024

Gjithsej: 2041

## Numri i pronarëve të ndarë sipas tipit, fizik juridik dhe të panjohur në periudhën kohore raportuese Janar – Mars 2024

Juridik	Fizik	EPanjohur	NumriTotal
7	634	0	641

### Shqyrtimi i qështjeve juridike të natyrës pronësore

Gjatë kësaj periudhe kohore – raportuese zyra kadastrale juridike ka pranuar 515 këshillime sugjerime dhe punë me palë.

Në këto shkëmbime këshillash dhe trajtime të rasteve të ndryshme nga situatë të ndryshme juridike, zyrtarët tanë kanë ofruar këshilla dhe sugjerime profesionale lidhur me zgjidhjen dhe ecurinë e lëndëve sipas kërkesave të palëve.

Vlenë për tu theksuar se gjatë periudhës raportuese kemi shqyrtuar mbi 75 raste të Kërkesave me shkrim për interpretim të disa rasteve dhe situatave e dokumentacioneve, këto kërkesa i kemi shqyrtuar dhe kemi dhënë opinionet tona lidhur me kërkesat e palëve.



Gjatë kësaj periudhe kam pranuar lëndë që kanë të bëjnë me:

Shpronësimin e parcelave, këmbimin e parcelave, kërkesa për marrje në shfritëzim të parcelave, identifikime të parcelave, dalje në teren etj.

Këmbim	Kompletimi I lëndës për këmbimin e pronës Shoqërore me pronën private bazuar në Vendimin e Kuvendit Komunal 01-Nr-016-74252 datë 27.11.2024 është nxjerr vendimi për ndryshim plotsimin e vendimit 01-Nr-16-4813 datë 27.06.2013, për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private, me qëllim të korrigjimit – përmirsimit të numrave të parcelave dhe sipërfaqeve të pronave private dhe publike.
Këmbim	Përgaditja e materialit për dërgim në Ministrinë e Financave për vlersimin e pronës së paluejtshme, bazuar në Vendimin e Kuvendit Komunal për këmbimin e pronës private me pronën publike.
Këmbim	Kërkesë për inicim të procedurës së shpronësimit në Suharekë, në rrugën “Luigj Nikolla” - Suharekës
Këmbim	Kompletimi i lëndës për këmbimin e pronës Shoqërore me pronën private bazuar në Vendimin e Kuvendit Komunal për shpalljen e interesit të përgjithshëm 01-Nr-016-13680 datë 29.02.2024 , për rregullimin e infrastrukturës publike në rrugën “ Mulla Nura dhe Gjergj Fishta” në qytetin e Suharekës
Këmbim	Kompletimi i lëndës për këmbimin e pronës Shoqërore me pronën private bazuar në Vendimin e Kuvendit Komunal për shpalljen e interesit të përgjithshëm 01-Nr-016-13682 datë 29.02.2024 , për rregullimin e infrastrukturës publike në rrugën ““Luigj Nikolla” - në qytetin e Suharekës
Prishtinë	Takim Zyrtar –punëtori 1 ditore me Agjensionin Kadastral të Kosovës dhe USAID. Ligji i ri për kadastrë.
Shpronësim	Kërkesë për shpronësimin e parcelës kadastrale P-01618-0, në vendin e quajtur “Livadhi te Mali”
Stravuçinë	Kërkesë për inicimin e parcelës kadastrale P-00607- 0 në vendin e quajtur “ Te vorrezat- Rezina”
Shpronësim	Kërkesë për shpronësim në Zonën Kadastrale në Sopijë, bazuar në vendimin e Komunës së Suharekës për shpalljen e interesit të përgjithshëm të dtës 19.09.2003, për zgjerimin e rrugës Shirokë –Sopijë.
Dalje në teren	30
Identifikime të parcelave	220
Takime me pale për qështje pronësore	60
Sopië Bartje Administrative	Aktvendim për bartje administrative lidhur me trollin ndërtimore 803/20 ZK Sopijë, bazuar në Aktvendimin e Drejtorisë Komunale për Punët Pronësore-Juridike të viti 1991.
Bartje Administrative	Grejkoc, <b>ngastra kadastrale nr. 878/51, sipërfaqja 617m<sup>2</sup>( 6 ari e 17metra katror), vendi i quajtur “Dushkaja Verdh”</b>
Bartje Administrative	Grejkoc, <b>ngastra kadastrale nr. 878/94, sipërfaqja 1000m<sup>2</sup> (10 ari),, vendi i quajtur “Dushkaja Verdh”</b>
Grejkoc	Kërkesa për informata për trollin ndërtimor 878-110 dhe trollin ndërtimor 878-11 // <a href="#">P.SH.KK.SUHAREKË SHTEPIA KULTURES</a> . Përgaditja dhe kompletimi i shkresave të lëndës lidhur me dhënien në shfrytëzim të këtyre trojeve ndërtimore.
Shpronësim	Kërkesë për shpronësim në Zonën Kadastrale në Sopijë, bazuar në vendimin e Komunës së Suharekës për shpalljen e interesit të përgjithshëm të dtës 19.09.2003, për zgjerimin e rrugës Shirokë –Sopijë.

Komunë	Përgaditja e materialit për publikim në platformën e performancës Komunale. Treguesi 1. Lista e përgaditur dhe e përditësuar me prona të planifikuara për dhënie në shfrytëzim. 2. Lista e përgaditur dhe e përditësuar me prona.
Avokati Komunes Gjykatën Themelore dega ne Suharek	Përgaditja e lëndës, dokumentacionin kopmplet lidhur me bartjen e pronës së shpronësuar për ndërtimin e Shkollës së Mesme “Skender Luarasi” në Suharekë, në mes të Rrahman Kryeziut dhe Komunës së Suharekës. Kërkesa jonë si Drejtori, që për këtë qështje juridike të procesohet lënda në organet kompetente.
Asamble	Me kërkesën e Kryetarit dhe Drejtorit të Drejtorisë kam Bashkëpunuar me Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Drejtorin e Urbanizmit në përgaditjen e lëndëve për inicim ne Asablen Komunale, për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pronave ne ZK Suharekë.
Suharekë	Takim me pal rreth procedures së këmbimit të pronës me rastin e hapjes së rrugës në lagjen Bajraktari në Suharekë.
Komun	Ne bashkëpunim me Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Emergjenc kemi shqyrtuar dhe përgaditur lëndë që kanë të bëjnë me shpronësimin dhe këmbimin e pronave.
Studenqan	Kërkes nga Kshilli i Fshatit Studenqan për ndarjen dhe dhënjen në shfrytëzim të sip. 0.15ha për familje të dëshmorit.
Studenqan	Shqyrtimi i kërkesës. Njoftim për Drejtorin dhe Kryetarin e Komunës lidhur me natyrën e kërkesës nga Kshilli i Fshatit Studenqan për ndarjen dhe dhënjen në shfrytëzim të sip. 0.15ha për familje të dëshmorit.
Gjinoc	Kërkes për dorzimin e shkresave për kthimin e tokës së konfiskuar
Gjinoc	Dorzimi i lëndës (shkresave) për kthimin e tokës së konfiskuar / dokumentet nga arkiva Komunës.
Të ndryshme	Kerkesa për dokumentet në lidhje me pronën e konfiskuar / dokumentet nga arkiva

## Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Në bazë të urdhëresës së Kryetarit mbi raportin e punës tre mujore, nga data **03.01.2024-29.03.2024**, ku gjatë periudhës tre mujore kemi punuar si më poshtë:

### 1) **Feim Gashi - Koordinator për Shërbime Publike dhe kontakte të përhershme me komunitete.**

Gjatë periudhës 3 (tre) muajore të vitit 2024, në DSHPE – e në veqanti në sektorin e Shërbime Publike janë kryer punë të ndryshme që kanë të bëjnë me natyrën e punës se kësaj Drejtorie. Disa nga punët më të rëndësishme, me të cilat isha i angazhuar në këtë drejtori janë:

- Bashkëpunimi dhe koordinimi si gjithmonë me stafin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente, për punët brenda ditës ,javës, muajit, si dhe tre mujorit të parë të këtij viti- 2024, për

kërkesat e dhe nevojat e ndryshme të qytetarëve të cilat i përkasin, Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente.

- Angazhimi si zakonisht çdo fillim vit në muajt e parë të vitit 2024, me vendim të Kryetarit si komision për performancën e Komunës, lidhur me përgaditjen e performancës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, të vitit parapark -2023 për çdo vit i raportojmë Koordinatorit të performacës z. Rinor Zyrapit, se sa projekte të Ujësllësit kanë qenë të planifikuara brenda vitit 2023, dhe sa projekte ujësllësit, janë realizuar brenda vitit 2023, po ashtu edhe sa projekte të kanalizimeve kanë qenë të planifikuara brenda vitit -2023, dhe sa projekte të janë realizuar brenda vitit 2023, ku kërkohet raport konkret me shkrim për se cilën fushë veq e veq.

- Si zakonisht çdo fillim vit, ka fundi i muajit Janar si dhe në tre mujorin e këtij viti kemi filluar me iniciimi i procedurave për mallra dhe shërbime për vitn 2024, si dhe inicime të ndryshme brenda Drejtorisë.

- Po ashtu si zakonisht çdo fillim vit i kemi filluar iniciimin e procedurave për projekte kapitale për vitn 2024, si për rrugë, kanalizime, trotuare, si dhe inicime të ndryshme brenda Drejtorisë.

- Kërkesat për çdo muaj për kërkesa fillestare dhe për zotime dhe pagesa të ndryshme brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

- Pranimi i faturave të shpenzimeve komunale të mallrave dhe shërbimeve, të investimeve kapitale, si dhe kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat shpenzimeve komunale të Rrymës,Ujit,Telefonit, Mbeturinave.

- Po ashtu kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat të ndryshme për mallra dhe shërbime brenda sektorit të Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

- Kryerja e pagesave për punëtorët e zjarrëfikësave dhe faturave të ndryshme për këtë sektor. - Iniciimi i procedurave minimale me zyrën e Prokurimit, për nevojat e zjarrëfikësave në kuadër të –DSHPE.

- Kontakte të shpeshta telefonike me KEDS-in, Hidroregjionin, Ekoregjionin, PTK-në etj, për nevojat e Komunës, të qytetarëve për zgjidhjen e kërkesave të tyre për mes telefonit.

- Caktimi nëpër komisione të ndryshme për nevojat e komunës.

- Përgaditja e kërkesave të KEDS-it, si dhe qytetarëve për pëlqimet konkrete të tyre.

- Realizimi i vizitave në teren për kërkesa të ndryshme (strehim, kanalizim, ujësllës dhe infrastrukturë), por gjithmonë me urdhër të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, dhe Emergjencë.

- Lëshimi i dokumenteve për persona fizikë dhe institucione,



- Raportimi i raporteve mujore për qdo muaj për faturat e paguara dhe të papaguara, për zyrtarin Kryesor Financiar të Drejtorisë së Financave.
- Kërkesa të shpeshta për ndryshime të faturave nga operatorët e ndryshëm, në bazë të kërkesës të cilën e bëjmë ne si Drejtori e Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë.
- Takime - konsultime të shpeshta me qytetar, për kërkesat dhe nevojat e tyre.
- Dhënja dhe pëlqimi i kërkesave për KEDSIN, si dhe bashkëpunime të shumta me ta.
- Pagesa Kostit për zgjidhje teknike për xhvendosjen e linjës 110Kv- zonën Industriale etj.
- Shpenzimi i Buxhetit me afatet e caktuara nga ZKF-ja, në bashkëpunim me Drejtorinë tonë, si dhe shumë kërkesa tjera pranë Drejtorisë.
- Komunikime të shpeshta brenda ditës, brenda javës me qytetarë për kërkesat dhe nevojat e tyre.
- Raportimi për zyrtarin kryesor financiar, lidhur me shtyerjen e projekteve nga muajt aktual dhe anasjelltas.
- Raportimi ditor për Drejtorinë për punet e kryera brenda ditës për nevojat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.
- Bashkëpunim të ndërsjellë me të gjitha sektorët e Drejtorive e në veqanti me Drejtorinë e Urbanizimit, me Zyrën e Prokurimit, me Drejtorinë e Arsimit ( DKA), me Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë e Katastrit e tjera), pastaj me “Hidro-regjionin Jugor” njësia Suharekë “ Eko-regjionin “ njësia Suharekë , KEDS-in , PTK-në etj.

## **2) Fisnik Tahiri, Zyrtar për ndërmarrje publike lokale dhe menaxhim te mbeturinave :**

Në bazë të përgjegjësisë së punës, gjatë periudhës **Janar-Mars**, kam punuar në këto detyra të punës:

**Gjatë muajit Janar**, kemi pranuar 27 Lënda, ku 14 lëndë janë refuzuar, 10 janë miratuar, 1 është përcjellë me aktpercjellës si dhe 2 janë në hedhur poshtë.

1 .Në kuadër të projektit mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit, gjatë këtij muaji kemi *Mirëmbajtja dhe pastrimi I rrugëve* lokale dhe trotuareve në Suharekë, (Luigj Gurakuqi, Ismail Qemajli, Hasan Prishtina, Mulla Nura, Hajdin Berisha, Xhavit Sylaj, Rruga te parku, Varrezat e dëshmorëve, Brigada 123 nga hyrja e qytetit deri tek derveni, Zeke Bajraktari, Naim Berisha, Omer Gega, Nene Tereza, rruga me gurë nga lumi mbrapa QPS-së, Milit Kryeziu, Skënderbeu, Xhavit Bajraktari, Ali Pash Tepelena dhe rrugët tjera te papara, këto rrugë pastrohen gjdo ditë. Rruga Ukë Bytyqi, Nga rruga e dolloceve deri tek derveni, rruga xhavit sylaj, Abdyl Rama deri tek restaurant Nori

2. Gjithashtu, në kuadër të projektit “Pastrimi i rrugëve nga Bora” operatori, ka qenë në kujdestari dhe ka pas intervenime në relacionet;

- 20.01.2024 ku ka filluar të bjerë borë në orët e hershme të mengjesit); Në relacionet: Maqitevë, Budakovë, Mohlan, Papaz, Grejqevc, Vraniq, Buzhalë, Grejkoc etj.
- Me datë 21.01.2024, kemi intervenuar, serish në këtë relacionet e lartëcekura, si dhe në Doberdelan, Samadrexhë, Grejkoc, etj.
- Po ashtu ka qenë në punë dhe ka mbajtur kujdestari.

### 3. Në kuadër të projektit “Ngritja e kapaciteteve drejt një shoqërie të shëndosh faza e dytë”

- Kam mbajtur takim me drejtorin e Arsimit si dhe shkollat që kanë realizuar projektin e PP1, (6 shkolla).
- Kam pasur takim me Arbër Bakija, kontraktori i platformes “Raporto brengen tuaj” me të cilën kemi biseduar lidhur me të arriturat e kesaj platforme.
- Kam pasur takim me z. Hysen Jerliu nga Komuna e Kamenicës, ku kemi diskutuar për interesim e kesaj komune për implementimin e projektit për PP1.

### 4. Në kuadër të projektit “Fuqizimi i veprimit lokal për klimën”, kemi mbajtur takimin informues lidhur me të arriturat e projektit si dhe objektivat tjera që do mund ti arrim.

### 5. Takime te ndryshme ne drejtorine tone.

- Me kërkesen e drejtorise së Inspekcionit kam qenë i ftuar në takim me përfaqesuesit e kforit ku kemi folur për gjendjen momentale për menaxhimin e mbeturinave në komunën tonë, ku nga ky takim ata u ndan të knaqur me informimin lidhur me menaxhimin e mbeturinave (24.01.2024). **Gjatë muajit Shkurt**, kemi pranuar 26 Lënda, ku 23 lëndë janë refuzuar, 2 janë miratuar, 1 është përcjellë me aktpercjellës.

1. Në kuadër të projektit mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit, dhe në bazë të palnit të veprimit ku kemi dakorduar që të bëhen punimet si në vijim: *Mirëmbajtja dhe pastrimi I rrugëve lokale dhe trotuareve në Suharekë*, (Luigj Gurakuqi, Ismail Qemajli, Hasan Prishtina, Mulla Nura, Hajdin Berisha, Xhavit Sylaj, Rruga te parku, Varrezat e dëshmorëve, Brigada 123 nga hyrja e qytetit deri tek derveni, Zeke Bajraktari, Naim Berisha, Omer Gega, Nene Tereza, rruga me gurë nga lumi mbrapa QPS-së, Milit Kryeziu, Skënderbeu, Xhavit Bajraktari, Ali Pash Tepelena dhe rrugët tjera te papara, këto rrugë pastrohen gjdo ditë. Rruga Ukë Bytyqi, Nga rruga e dolloceve deri tek derveni, rruga xhavit sylaj, Abdyl Rama deri tek restaurant Nori. *Mirëmbajtja e shesheve të qytetit* (Parku i qytetit, parku i dëshmorëve, parku tek biblioteka e qytetit, parku te muzeu i qytetit, parku te qyteti i vjetër, parku i lojërave këto pastrohen gjdo ditë. *Larja e rrugëve dhe trotuareve*, nuk kemi bërë shërbim *Pastrimi i shtratit të lumit*, nuk kemi bërë shërbim
2. Në kuadër të projektit Mirëmbajtja e rrugëve lokale nga Bora, Operatori në fjalë ka mbajtur kujdestari, deri me tani nuk ka pasur nevoj për intervenime. Rruget janë të pastruar dhe të të kalueshme për qarkullim.
3. Në kuadër të projektit “Ngritja e kapaciteteve njerzore drejt një shoqërie të shëndosh” kam filluar me ligjeraten PP1 Edukimi mjedisor, ku gjate kesaj periudhe kam ligjeruar në këto shkolla ; “28 Nëntori” Doberdelan, “Flamuri Arbrit” Reshtan, “Edit Durham”

Mushtisht“ Dëshmoret e Kombit” Vraniq, “Shaban Mazreku” Sopijë, “17 Shkurti” Shirokë, “ Drita” Gelacë, “ Migjeni” Gjinoc, “ 7 Marsi” Suharekë, “ Destan Bajraktari” Suharekë, “ Sadri Duhla” Duhël, “ Kongresi i Manastirit” Studenqan, “ Dëshmoret e Grejkocit” Grejkoc, “ Gj.K. Skenderbeu” Sallagrazhd

- Po ashtu, kam mbajtur takim me z. Paulo, Senada dhe Jonin, lidhur me implementin e projektit pas perfundimit te tij, (ku ky projekt perfundon ne Qershor te 2024), po ashtu na ifnormoj Joni, qe deri me tash aplikacionin qe e kan downlodu qytetar te komune sone janë si në vijim; 13 Android dhe 31 Aple.
- 4. Në kuadër të projektit “Fuqizimi i veprimit lokal për klimën”, kemi mbajtur takimin informues lidhur me të arriturat e projektit si dhe objektivat tjera që do mund ti arrim, po ashtu jemi duke analizuar edhe objektivat e ketij plani
- 5. Ne kuader te projektit “ Eleminimi i deponive ilegale ne Komunë”, kemi filluar se vizituari deponit e reja te cilat do te pastrohen, ne relacionet ; Peqan (2), Sllapuzhan (3), Semetisht (3), Breshanc (2), Nishor (4),
- 6. Takime të ndryshme ne drejtorine tone.
  - Kam zhvilluar takim me z. Hazir Isufin, perfaqesues nga Demokracia plus, lidhur me aplikacionin qe do ta riaktizojme ne ndreqe.com,
  - Kam mbajtur takim ne sellen e bordit të drejtoreve, ku kemi filluar se punuari per performancen e komunave raportimi.

**Gjatë muajit Mars**, kemi pranuar 38 Lënda, ku 11 lëndë janë refuzuar, 18 janë miratuar, 1 është përcjellë me aktpercjellës dhe 8 janë në proces.

1. Në kuadër të projektit mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit, dhe në bazë të palnit të veprimit ku jemi dakorduar që të bëhen punimet si në vijim: *Mirëmbajtja dhe pastrimi I rrugëve lokale dhe trotuareve në Suharekë*, (Luigj Gurakuqi, Ismail Qemajli, Hasan Prishtina, Mulla Nura, Hajdin Berisha, Xhavit Sylaj, Rruga te parku, Varrezat e dëshmorëve, Brigada 123 nga hyrja e qytetit deri tek derveni, Zeke Bajraktari, Naim Berisha, Omer Gega, Nene Tereza, rruga me gurë nga lumi mbrapa QPS-së, Milit Kryeziu, Skënderbeu, Xhavit Bajraktari, Ali Pash Tepelena dhe rrugët tjera te papara, këto rrugë pastrohen gjdo ditë. Rruga Ukë Bytyqi, Nga rruga e dolloceve deri tek derveni, rruga xhavit sylaj, Abdyl Rama deri tek restaurant Nori. *Mirëmbajtja e shesheve të qytetit* (Parku i qytetit, parku i dëshmorëve, parku tek biblioteka e qytetit, parku te muzeu i qytetit, parku te qyteti i vjetër, parku i lojërave këto pastrohen gjdo ditë. *Larja e rrugëve dhe trotuareve*, nuk e kemi bërë shërbim *Pastrimi i shtratit të lumit* , nuk kemi bërë shërbim. Është bërë mirëmbajtja e lapidarëve në vendbanimet; Mushtisht, Caralevë, Bukosh,
2. Në kuadër të projektit Mirëmbajtja e rrugëve lokale nga Bora, Operatori në fjalë ka mbajtur kujdestari, deri me tani nuk ka pasur nevoj per intervenime. Rruget janë të pastruar dhe të të kalueshme për qarkullim.
3. Në kuadër të projektit “Mirëmbajtja dhe pastrimi i deponive” kemi vazhduar në eleminin dhe pastrimin e deponive ilegale në Komunë: Peqan, Sllapuzhan, Semetisht, Nishor.

4. Në kuadër të projektit, Ngritja e kapaciteteve njerzore drejt nje shoqerie te shendosh faza e dytë, e kemi pasur takimim me perfaqesuesit e JICA-s, në zyrën e kryetarit, ku unë kam prezantuar progresin e projektit në fjalë.
  - a. Ku deri me tani janë implementuar në 26 shkolla PP1kan mbetur edhe 12 shkolla per implementim.
  - b. Kam pasur takim me zyrtaret zonjen Kawanishi me të cilen kam biseduar lidhur me vlersimin e performances komunale te projektit ne fjal. Po ashtu, kam pasur takim edhe me z. Kanachi, me të cilin kam biseduar lidhur me objektivat e planit komunal per menaxhimin e mbeturinave, se si do ta implementojme diteve ne vijim.
  - c. Kam zhvilluar takim me zyrtarin z. Sato, i cili ka bere disa pyetje lidhur me progresin e prorekitit, dhe aplikacionin ne veqanti.
  - d. Kam pasur takim me zyrtarin z. Jon Gota si dhe znj. Senada bekteshi, lidhur me progresin e projektit, dhe arsyen e mos futjes se rregullores komunale per menaxhim e mbeturianve.
5.
  - a. Kemi mbajtur takim informues lidhur me raportimin e performances ne sellen e bordit me komplet stafin. Po ashtu, une jam duke raportuar ne AMMK, si dhe performance të komunes.
  - b. Kemi vazhduar me raportim si në sistemin e performaces komunale si dhe në AMMK, i cili eshte i paraper per raportim deri me 31.03.2024.
  - c. Me ftesë së AMMK-së, kam qenë në seminarin e organizuar në Istog, lidhur me aplikacionin i cili ka pasur ndryshim nga ai i kaluari.
  - d. Kemi vazhduar takime javore me grupin e performances komunale, per progresin dhe sfidat gjate raportimit.

### *Rikapitulim:*

Deri me tash kanë ardhur në drejtorinë 91 kërkesa të ndryshme (100%),

- 30 kërkesa janë miratuar apo 32.96%,
- 48 janë refuzuar apo 52.74%
- 3 janë deleguar me aktpercjellsa ne drejtori te ndryshme 3.30 %
- 2 janë jedhur posht apo 2.20 %
- 8 sosh janë në proces apo 8.80.

Pastrimi i rrugëve lokale, 41262 m’

Mirembajtja dhe pastrimi i shesheve, parqeve, shtigjeve te ecjes dhe lapidarëve, 25230 m2

Pastrimi dhe mirembajtja e /hedhurinave ne varreza, 21,000 m2

Mirembajtja e gjelbrimit ne parqe, sheshe, shtigje te ecjes dhe pergjate brezit rrugor, 38862 m2

Mirembajtja dhe pastrimi i hapsirave publike (të perbashketa) ne objektet shumebanesore 64 cope

Largimi I mbeturinave shtazore, 55 copë.

Largimi dhe transporti i mbeturinave me vëllim 68.5 ton

### 3. Besim Demiri- Insp.i parandalimit nga zjarri

Lënda: Raport i punës për periudhën Janar-Mars 2024

Më poshtë do të evidentoj punët të cilat janë kryer në periudhën kohore Janar-Mars 2024 duke u bazuar në Planin vjetor të punës.

1. Inspektime të rregullta.....	14
2. Inspektime fillestare.....	4
3. Në sektorin Publik.....	3
4. Në sektorin privat.....	15
5. Inspektime kontrolluese.....	10
6. Masa të shqiptuara.....	102
7. Pelqime.....	5
9. Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve.....	1
10. Vërtetime .....	3
11. Shkresa të ndryshme.....	4

#### Enver Bytyqi, Zyrtar Profesional për Projekte

Në bazë të detyrave të punës sipas të cilave jam i angazhuar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe sipas ndarjes se detyrave ne kuadër te drejtorisë, për periudhen Janar-Mars/2024 i kam kryer sipas aktiviteteve të përditshme. Puna ime në DSHPE kryesisht varet nga detyrat të cilat i përcakton eprori dhe angazhimet tjera nga sektorët tjerë te cilët veprojnë ne Komune. Konsideroj se të gjitha detyrat e punës që më janë dhënë i kam realizuar.

Gjatë kësaj kohe në kuadër të menaxhimit të kontratave publike ne sistemin e elektronik te prokurimit kam plotësuar dhe verifikuar dokumentet e dorëzuara. Kame realizuar vizita në teren duke inspektuar punimet e realizuara në vitin paraprak dhe ndikimin e kushteve atmosferike në gjendjes e projekteve.Sipas vlerësimit të bërë në teren ju njoftoj që për projektet të cilat kam qenë menaxher i kontratës gjendja është e mire dhe nuk ka defekte të evidentuara për momentin. Punimet kanë filluar në disa kontrata dhe janë në realizim e sipër, ku gjatë tërë periudhës jam angazhuar në përcjelljen e punimeve dhe realizimin e tyre.

Në vazhdim po ju jap në formë tabelave aktivitetet kryesore:

Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit
<b>Specifikimet teknike</b>	Kontrollimi i Specifikimeve teknike per projektin e rrugëve ne Grejqevc. Meqenëse kamë qenë menaxher i kontratës në rregullimin e rrugëve të fshatit, gjatë procesit

		<p>të punëve sipas vendimit të ZKA është rregulluar rruga “Seferi” ndërsa rrugët tjera janë shtruar me zhavorr.</p> <p>Disa rruge të cilat janë përsëritur në dy vitet e kaluara kanë mbetur pa u realizuar, kështu që unë i kam bërë matjet e duhura në teren për hartimin e specifikimeve teknike për këto rrugë në mënyrë që me projektin e vitit 2024 dhe buxhetin e planifikuar të rregullohen edhe këto segmente.</p>
<b>Menaxhim Kontratës</b>	<b>te</b>	<p>Kam zhvilluar komunikimin me operatorët ekonomik të cilët i kanë kontratat në vazhdim për vitin 2024.</p> <p>Koordinimi për rifillimin e punëve pas përmirësimit të kushteve atmosferike.</p> <p>Angazhimi i plotë në menaxhimin e kontratës për projektet ku kanë filluar punimet ( Rregullimi i rrugëve në Studencan, Grejkoc, Bllacë dhe Luzhnicë)</p> <p>Në projektin e fshatit Luzhnicë kanë përfunduar të gjitha punimet, janë bërë të gjitha testimet dhe matjet në teren për finalizimin e plotë të kontratës.</p>
<b>Vizita në teren</b>		<p>Janë bërë vizitat në teren në projektet e realizuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rrugët lokale në Nepërbisht të realizuara në vitin 2023</li> <li>• Rruga kryesore në Samadraxhë e asfaltuar në vitin 2023</li> <li>• Rrugë në fshatin Duhël 2023</li> <li>• Rruga në fshatin Grejqevc 2023</li> <li>• Rrugët në fshatin Dubravë të realizuara në vitin 2023</li> </ul> <p>Të gjitha vizitat janë bërë me qëllim të inspektimit pas përkeqësimit të kushteve atmosferike dhe ndikimi i tyre në punimet e realizuara.</p> <p>Vizita sistematike dhe të rregullta në teren në vendpunishtet ku janë duke u zhvilluar punimet.</p> <p>Fshatin Bllacë Fshatin Studençan Fshatin Grejkoc</p>
<b>Menaxhimi kontratave e-prokurim</b>	<b>i</b>	<p>Të gjitha dokumentet e dorëzuara janë vlerësuar dhe kompletuar në sistemin e prokurimit elektronik në modulën menaxhimi të kontratave.</p> <p>Është bërë vlerësimi i performancës së kontraktuesve për kontratat e përfunduara në sistemin e prokurimit elektronik.</p> <p>Në vazhdim janë duke u menaxhuar kontratat në sistemin e prokurimit elektronik.</p>

#### Gjendja e projekteve: Menaxhimi i Kontratave

TË DHËNA PLOTËSUESE VETËM PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA NË KËT VIT KALENDARIK 2023			
Titulli i Kontratës	Kontrata	Gjendja	Data e përfundimit
<b>Ndërtimi i rrugëve lokale „Hajriz Xhema, „Tetë Vëllezërit, „Seferi -Faza e dytë dhe Ndërtimi i rrugëve lokale Vazhdimi i rrugëve Seferi, Dy Martir, Veterani Grejqevc-Ritender 624-23-9603-5-2-1/C1057</b>	2 vjeçare	Përfunduar	22.12.2023

Ndërtimi i rrugëve lokale, Sejdi Ramadani -vazhdim, Adem Rrustemi -vazhdim; Hajdar Isufi -vazhdim; Jetish Limani - vazhdim - faza e dytë dhe Ndërtimi i rrugëve lokale Malokaj-segment ,vazhdim i rrugës Faik Maliqaj vazhdim i rrugës Adem Rrustemi 624-23-8109-5-2-1/C1042	2 vjeçare	Përfunduar	16.11.2023
Ndërtimi i rrugëve lokale „Lagja Tafolli - vazhdim dhe „Lagja Vrella -vazhdim -Faza e dytë dhe Ndërtimi i rrugëve lokale Vazhdim i rrugës në Lagjen Tafolli Qadrak 624-23-8039-5-2-1/C1038	2023	Përfunduar	13.10.2023
Ndërtimi i rrugëve lokale Bajram Sh. Kryeziu , Mal Hajdari , „Xhemajli Bytyqi „Isa Shala -Faza e dytë dhe Ndërtimi i rrugëve lokale Isa Shala ,Haxhi Zyberi ,Muhamet Qamili – Nprebisht 624-23-8016-5-2-1/C1039	2 vjeçare	Përfunduar	08.11.2023
Ndërtimi dhe asfaltimi i unazës në Samadraxhë 624-23-769-5-2-1/C982	2023	Përfunduar	24.08.2023
Ndërtimi i rrugëve lokale Shote Galica segment „Sherif Qatani segment dhe Vëllëzrit Qatani -Faza e dytë dhe Ndërtimi i rrugëve lokale Vllezerit Qatani -segment ,Hivzi Sylejmani Duhël 624-23-8002-5-2-1/C1050	2 vjeçare	Përfunduar	22.11.2023
Ndërtimi i rrugëve Selim Fondaj dher Hamdi Gashi në Peqan 624-23-2778-5-2-1/C995	2023	Përfunduar	17.11.2023
Ndërtimi dhe funksionalizimi i objektit në oborrin e Komunës (QSHQ) 624-23-3873-1-2-1/C1003	2023	Përfunduar	29.09.2023

#### Të dhënat për Kontratat në realizim nga viti 2023

<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Kontrata</b>	<b>Gjendja</b>
Ndërtimi i rrugëve lokale “Azman Alija”, “Kodra e Nures” vazhdim, “Fisniket”, “Qershia”, “Daut Rexhepallari” Vazhdim „Gani Kukaj vazhdim-faza e dytë dhe Ndërtimi i rrugëve lokale Gani kukaj -segment ,Sherif Qadraku -segment ,Qershija-segment Gelancë  624-23-8092-5-2-1/C1051	2023/2024	<b>Realizim</b>  Punimet ende nuk kane filluar për shkak te vonesave ne përcaktimin e segmenteve për realizim dhe përkeqësimit te kushteve atmosferike.  Kontrata komplet do te realizohet brenda buxhetit te vitit 2024
Ndërtimi i rrugëve lokale „Rexhep Zmajlaj , „Shaban Rexhepi , „Dan Hyseni , Rexhë Kokaj dhe Rrustem Rexha ,Shaban Lushaj , dhe Beqir Fejza ,në Grejkoc -Faza e dytë dhe Ndërtimi i rrugëve lokale Rruga e Xhamisë ,Ukë Sylejmani ,Sinan Kicaj, Shaip Kadriaj ,Smajl Muharremi Grejkoc	2023/2024	<b>Realizim</b>  Punimet për vitin 2023 kane përfunduar sipas planifikimit buxhetor dhe janë realizuar pagesat.

624-23-8088-5-2-1/C1053		Punimet kanë rifilluar dhe janë duke u realizuar në dinamikën e paraparë.
<p><b>Ndërtimi i rrugëve lokale „Afrim Bucaj segment, „Tahir Sinani segment, në Luzhnicë- Faza e dytë dhe Ndërtimi i rrugëve lokale Vazhdimi i segmentit Tahir Sinani dhe Afrim Buqa Luzhnicë</b></p> <p>624-23-8046-5-2-1/C1043</p>	2023/2024	<p><b>Realizim</b></p> <p>Punimet për vitin 2023 kane përfunduar sipas planifikimit buxhetor dhe janë realizuar pagesat.</p> <p>Punimet janë requalizuar në tërësi dhe kontrata ka përfunduar, është proceduar për pagesë vlera e kontratës sipas planifikimit buxhetor.</p> <p><b>Vërejtje:</b></p> <p>Në këtë kontratë nuk janë realizuar pagesat komplet pasi që ka mungesë të mjeteve buxhetore për të cilat AK duhet t'i siguroj për të realizuar pagesat në tërësi.</p> <p><b>Vlera e mjeteve buxhetore të papaguara është e paraqitur në raportin përfundimtar dhe kapë vlerën financiare prej....3,460.55 €</b></p>
<p><b>Ndërtimi i rrugëve lokale, Ndërtimi i rrugëve, Eqerem Qabej -segment. Djerrinat , Gurra e Fshatit , Brezi i Artë , Ararët , Arat dhe Arif Gashi -Faza e dytë dhe Ndërtimi I rrugëve lokale Kosova vazhdim ,Shqiptari -vazhdim Eqrem Qabej segmente Besnik Perzhaku -segmenet Studenqan</b></p> <p>624-23-7930-5-2-1/C1055</p>	2023/2024	<p><b>Realizim</b></p> <p>Punimet për vitin 2023 kane përfunduar sipas planifikimit buxhetor dhe janë realizuar pagesat</p> <p>Kanë rifilluar punimet në vitin 2024 dhe janë duke u realizuar sipas dinamikës së paraparë.</p>



<p>Ndërtimi i rrugëve lokale Bregu , Koretniku , Bashkim Suka -vazhdim, Bllacjanët , Dukagjini , Mehmet Suka , Beteja e Bllacës -Faza e dytë dhe Ndërtimi i rrugëve lokale Vlora ,Prrocka ,Mrizet ,Kroni i shelqes ,Malsia ,rruga Livadhet ,Lama Mehmet Lumi -degzim dhe rruga Bislim Zekolli –degzim</p> <p>624-23-7923-5-2-1/C1056</p>	<p>2023/2024</p>	<p><b>Realizim</b></p> <p>Punimet kane filluar vetëm me një segment mirëpo kushtet atmosferike kane ndikuar qe ato te pezullohen deri ne momentin e përmirësimit te tyre.</p> <p>Nuk është realizuar asnjë pagesë</p> <p>Kontrata komplet do te realizohet brenda buxhetit te vitit 2024</p> <p>Kanë filluar punimet në realizimin e kontratës dhe janë në realizim e sipër.</p> <p><b>Vërejtje:</b></p> <p><b>Vlera e kontratës ... 100,412.45 €</b></p> <p><b>Vlera e planifikimit buxhetor... 94,000.00 €</b></p> <p><b>Për tu realizuar kontrata në tërësi Komuna e Suharekës duhet të planifikoj pjesën e mbetur të mejteve të cilat nuk janë të planifikuara e që kapë vlerën prej ... 6,412.45 €</b></p>
--	------------------	---

### Arsim Rexhepaj - Zyrtar për Projekte

Në bazë të detyrave të punës sipas të cilave jam i angazhuar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për muajt **Janar-Mars 2024**, i kam kryer shërbimet në punën time të përditshme. Duhet të theksohet që puna ime kryesisht mvaret nga detyrat të cilat i marr drejtpërdrejt nga eprori dhe organet më të larta të komunës për realizimin e projekteve sipas planifikimit të bërë dhe të gjitha detyrat e marra kamë perfunduar me kohë, dhe pjesërisht mvaret nga kërkesat e palëve (përgjigje, vizita në teren etj.). Performanca ime në kryerjen e detyrave të punës mvaret edhe nga bashkëpunimi me zyrtar të tjerë të drejtorisë sidomos në punën e përbashkët të cilat i kryejm në kuadër të detyrave të punës (komisione, bashkëpunim profesional etj).

Gjatë kësaj periudhe kam kryer punët dhe shërbimet si në vijim:

- Menaxhim dhe mbikqyrje të projekteve të cilat janë duke u zhvilluar punimet (kontrata te cilat jane aktive siq jane): menaxhimi i kontratave:

#### **Mbi menaxhimin e kontratave të cilat jame i ngarkuar:**

**-Kontrata:**

**-Ndertimi dhe sanimi i rrugeve lokale Sopije-Vraniq dhe Reqan-Bukosh**

Ne kete kontrate nga viti i kaluar nuk eshte punuar pasiqe gjate ketij 3 mujorshi nuk ka pasur mundesi zhvillimi të puneve nga kushtet atmosferike.

Nga muaji Prill do paraqesim kerkesat per rifillimin e puneve si dhe perfundimin e kontrates.

**-Ndertimi i rrugeve lokale Shadan Gashi, Komandant Drini-segment, Bashkim Kabashi-segment, Shtjefen Gjeqovi, Isment Kodra-segment ne Leshan-ritender**

Ne kete kontrat punimet kane perfunduar punimet afer 80% te puneve, pozicionet e mbetura jane pozicione te puneve te asfaltit.

Me rifillimin e puneve te bazave te asfaltit dhe permissimi i kushteve atmosferike do te vazhdohet me punen dhe perfundimin e pjeses se mbetur te kontrates.

### **Mentor Gallapeni, Zyrtar për Projekte**

Në bazë të detyrave të punës sipas të cilave jam i angazhuar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për periudhën Janar-Mars 2024, i kam kryer shërbimet në punën time të përditshme. Duhet të theksohet që puna ime kryesisht mvaret nga detyrat të cilat i marr drejtpërdrejt nga eprori dhe organet më të larta të komunës për realizimin e projekteve sipas planifikimit të bërë dhe të gjitha detyrat e marra kamë perfunduar dhe pjesërisht mvaret nga kërkesat e palëve (përgjigje, vizita në teren etj.). Performanca ime në kryerjen e detyrave të punës mvaret edhe nga bashkëpunimi me zyrtar të tjerë të drejtorisë sidomos në punën e përbashkët të cilat i kryejm në kuadër të detyrave të punës (komisione, bashkëpunim profesional etj).

Gjatë kësaj periudhe kam kryer punët dhe shërbimet si në vijim:

- Sistemimi i lëndëve të realizuara gjatë vitit paraprak,
- Analiza e buxhetit për vitin paraprak 2023
- Analiza e buxhetit për vitin 2024
- Analiza e kontratave dhe gjendja e pagesave,
- Takime për diskutimin dhe vlerësimin e gjendjes së projekteve,
- Vizita në teren për vlersimin e kontratave të realizuar 2022-2023 dhe kontratave në realizim,
- Vizita në teren për hartimine specifikave për kompletimin e dokumentacionit për inicimin procedurave të prokurimit.

### **Florinda Isufaj-Zyrtare për Mirëqenie Sociale (e autorizuar nga Kryetari në DSHPE)**

- *-Në bazë të urdhëresës së Drejtorit dhe Kryetarit mbi raportin tre mujor të punës ku gjatë kësaj periudhe 01.01.2024-28.03.2024kemi bërë pranimin dhe regjistrimin e lëndëve-kërkesave të palëve*
- ***kujtithsej kanë ardhur në drejtorinë tonë 91 kërkesa të ndryshme :***
- 30 kërkesa janë miratuar apo 32.96%,
- 48 janë refuzuar apo 52.74%
- 3 janë deleguar me akt percjellsa ne drejtori te ndryshme 3.30 %
- 2 janë hedhur posht apo 2.20 %
- 8 sosh janë në process apo 8.80 %

*Kemi filluar edhe me inicimet e procedurave të prokurimit-deklaraten e nevojave dhe përkatimit të disponueshmërsisë së fondeve ku gjatë këtij tre mujori kemi inicuar gjashtë si dhe kamë përgaditë kërkesat për zotimin e mjeteve për njëzet e tetë projekte të investimeve kapitale,po ashtu kam asistuar në angazhimet dhe takimet e Drejtorit si dhe punë të tjera të ndryshme të drejtorisë me urdhër të drejtorit.*

### Raport tre mujor i Intervenimeve të e NjPZSh - 2024

Nr.	Nr. Regj.	Data	Emir dhe Mbiemri	Vendlindja	Vendngjarja	Sektori	intervenimi	Çka është demtuar
01.	01/01	01.01.2024	Eko Regjioni		Suharekë	Shoqëror	Zjarrë	Kontajner i mbeturinave
02.	02/01	01.01.2024	Veprim Krasniqi		Autostrada Suharekë-Duhël	Privat	Zjarrë	Vetur Audi (04-893-AH)
03.	03/01	01.01.2024	Lirim Bylykbashi		Budakovë	Privat	Int.Teknik	Tërheqja e automjetit Audi Q7
04.	04/01	01.01.2024	I paidentifikuar		Suharekë te "VENEZIA"	Privat	Int.Teknik	Tërheqja e Qenit nga puseta
05.	05/01	02.01.2024	Sadik Kadriaj		Krushicë	Privat	Aksident	Vetaksident veturë (Hyundai BEL-FS302)
06.	06/01	03.01.2024	I paidentifikuar		Sallagrazhdë	Privat	Zjarrë	Njehsori dhe përqesit elektrik
07.	07/01	08.01.2024	I paidentifikuar		Suharekë te Stacioni policor	Privat	Aksident	Audi 04-934-JR dhe VW7 04-808-JI
08.	08/01	09.01.2024	Gazmend Morina	Samadraxhë	Samadraxhë te xhamia	Privat	Zjarrë	Kutia shpërndarë e rrymës
09.	09/01	11.01.2024	I paidentifikuar		Suharekë te sheshi	Privat	Zjarrë	Mbeturina
10.	10/01	11.01.2024	I paidentifikuar		Peqan	Privat	Zjarrë	Njehsori elektrik
11.	11/01	13.01.2024	I paidentifikuar		Grejokoc	Privat	Zjarrë	Bari i thatë
12.	12/01	21.01.2024	Agim Buqa	Studenqan	Studenqan	Privat	Zjarr	Oxhaku i shtëpis
13.	13/01	21.01.2024	Elfije Bytyqi	Studenqan	Studenqan	Privat	Zjarr	Oxhaku i shtëpis
14.	14/01	21.01.2024	Elfije Bytyqi	Studenqan	Studenqan	Privat	Zjarr	Oxhaku i shtëpis
15.	15/01	27.01.2024	KEDS		Gjinoc	Shoqëror	Zjarr	Shtyllë elektrike
16.	16/01	30.01.2024	Banesat e FAMIS		Suharekë	Shoqëror	Zjarrë	Oxhaku i banesës
17.	17/01	30.01.2024	Eko regjioni		Suharekë	Shoqëror	Zjarrë	Kontajner i mbeturinav
18.	01/02	02.02.2024	I paidentifikuar		Peqan	Privat	Zjarrë	Bari i thatë
19.	02/02	04.02.2024	I paidentifikuar		Semetisht	Privat	Zjarrë	Bari i thatë
20.	03/02	04.02.2024	I paidentifikuar		Grejokoc	Privat	Zjarrë	Bari i thatë
21.	04/02	05.02.2024	Florian Loka "DIVANI - SHPK"		Autostrada Prizren - Suharekë	Privat	Zjarrë	Kamionetë Mercedes 05-667-EF
22.	05/02	05.02.2024	I paidentifikuar		Leshanë	Privat	Zjarrë	Bari i thatë
22.	06/02	06.02.2024	I paidentifikuar		Peqan	Privat	Zjarrë	Bari i thatë
23.	07/02	06.02.2024	I paidentifikuar		Dubravë	Privat	Zjarrë	Bari i thatë
24.	08/02	07.02.2024	I paidentifikuar		Caparc	Privat	Zjarrë	Bari i thatë
25.	09/02	07.02.2024	I paidentifikuar		Reshtan	Privat	Aksident	Aksident mes dy veturave
26.	10/02	07.02.2024	I paidentifikuar		Studenqan	Privat	Zjarrë	Bari i thatë
27.	11/02	08.02.2024	Reshat Kryeziu		Leshanë	Privat	Zjarrë	Lëndë djegse (drurë)
28.	12/02	09.02.2024	I paidentifikuar		Suharekë Afër kooperativës	Privat	Zjarrë	Bari i thatë
29.	13/02	10.02.2024	SHFMU "Skender Luarasi"		Suharekë	Shoqëror	Shërbime	Ujrat atmosferike
30.	14/02	10.02.2024	I paidentifikuar		Muhalan	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë malorë
31.	15/02	10.02.2024	I paidentifikuar		Studenqan	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë malorë
32.	16/02	10.02.2024	I paidentifikuar		Shirokë afër DAMPERIT	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë
33.	17/02	10.02.2024	I paidentifikuar		Doberdelan	Privat	Zjarrë	Zjarrë malorë
34.	18/02	10.02.2024	I paidentifikuar		Grapit Studenqan	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë malorë
35.	19/02	11.02.2024	I paidentifikuar		Gjinoc	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë malorë

36.	20/02	11.02.2024	KEDS		Shirokë afër KEDS-it	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë malorë
37.	21/02	14.02.2024	I paidentifikuar		Carralevë	Shoqëror	Zjarrë	Mbeturina
38.	22/02	16.02.2024	Mejdi Sylaj		Suharekë	Privat	Zjarrë	Oxhak
39.	23/02	16.02.2024	I paidentifikuar		Doberdelan	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë malorë
40.	24/02	18.02.2024	I paidentifikuar		Studenqan	Privat	Zjarrë	Mbeturina
41.	25/02	19.02.2024	I paidentifikuar		Baqevcë	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë
42.	26/02	19.02.2024	I paidentifikuar		Studenqan	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë
43.	27/02	20.02.2024	I paidentifikuar		Leshan	Privat	Zjarrë	Mbeturina
44.	28/02	21.02.2024	I paidentifikuar		Studenqan	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë
45.	29/02	21.02.2024	I paidentifikuar		Budakovë	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë malorë
46.	30/02	21.02.2024	I paidentifikuar		Grejnoc	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë
47.	31/02	22.02.2024	Zenel Lumi		Bllacë	Privat	Zjarrë	Shtëpi banimi
48.	32/02	21.02.2024	Agro Kosova Holding		Gjinoc	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë
49.	33/02	22.02.2024	I paidentifikuar		Doberdelan	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë malorë
50.	34/05	22.02.2024	I paidentifikuar		Gelancë	Privat	Zjarrë	Zjarrë fushorë
